

# M. Scott Peck

## Rruga në të cilën rrallë shkohet

### Pjesa I dhe II

albas

Titulli i origjinalit:
*Scott Peck*
*THE ROAD LESS TRAVELED*
Copyright © 1978 by M. Scott Peck
Preface copyright © 1985 by M. Scott Peck
Introduction copyright © 2002 by M. Scott Peck

Botues:
Latif AJTULLAI
Rita PETRO

Redaktore:
Natasha PEPIVANI

Grafika:
Eva KUKALESHI

Fotot e përdorura janë vepra të skulptorit George Segal

© Albas, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Shtypur në shtypshkronjën:
IDEA PRINT

---

Shtëpia botuese Albas
Në Tiranë: Rr. "Budi", pallati "Classic Construction", nr.2
Tel: 00355 42 379 184; e-mail: info@albas.al
Në Tetovë: Rr. "Ilinden", nr. 105
Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas_te@yahoo.com
Në Prishtinë: Rr. "Muharrem Fejza", p.n.
Tel: 00377 45 999 770
e-mail: albas_pr@yahoo.com

*libër për ngritjen shpirtërore...*

Përktheu: LATIF AJRULLAI

## *Parathënie*

Libri i psikanalistit bashkëkohës Skot Pek *Rruga në të cilën rrallë shkohet* është nga më të lexuarit sot në botë. Njerëzit kanë gjetur në të një analizë të vërtetë dhe të sinqertë për ngritjen shpirtërore të vetvetes. Ky libër, më mirë se një duzinë ilaçesh, mund ta ndihmojë e ta lehtësojë secilin prej nesh për të bërë një zgjedhje sa më të drejtë, veçanërisht, kur gjendemi në udhëkryq. Para se ta përgatisnim librin, unë dhe kolegët e mi, menduam që ky botim do të ishte veçanërisht i vlefshëm për lexuesin shqiptar, i cili nuk e ka patur asnjëherë mundësinë dhe kulturën për të kërkuar trajtim terapeutik.

Autori përpiqet të jetë sa më objektiv dhe korrekt në trajtimin e temave të mëdha si *Dashuria* apo *Dhimbja*, të cilat i fokuson jo vetëm në dritën e shkencës psikologjike, por futet dhe në trajtime filozofike, sociologjike, teologjike, madje dhe poetike, duke i shkrirë të gjitha këto në përvojën jetësore të vetvetes dhe të rrethit ku ai jeton. Vetë titulli i librit është sa sugjerues, aq edhe joshës; ai të fton në një rrugë, nëpër të cilën vërtetë shkohet shumë rrallë, por me mbështetjen, përkrahjen, sinqeritetin dhe dashurinë që të ofron ky autor bashkëkohës, mund ta bëjë lexuesin të jetë dhe ai, papritur, pjesëmarrës në rrugën e ngritjes së vet shpirtërore. Për Skot Pekun, por dhe për njerëz të tjerë që mendojnë dhe jetojnë si ai, Dashuria dhe Puna janë gjërat më të shenjta dhe të vetmet udhëheqëse, që të çojnë në rrugën për arritjen e lumturisë së vetvetes dhe të të tjerëve.

Më tepër se gjithçka dhe mua më shtyu Dashuria që të marr për herë të parë rrugën e përkthyesit dhe të nxjerr në gjuhën shqipe këtë vepër të njohur në shumë vende të botës.

L. A.